

Termt e referencës : Çmimi i Gazetarisë për Varfërinë 2016

1. Përmbledhje

Viti 2016 shënoi përmbylljen e Objektivave për Zhvillim të Mijëvjeçarit (OZHM) të OKB-së dhe fillimin e Objektivave për Zhvillim të Qëndrueshëm (OZHQ) të OKB-së. Luftimi i varfërisë – objektivi i parë dhe ndoshta më i rëndësishëm global – ende mbetet një sfidë në Kosovë.

Megjithëse hulumtimet e mëhershme tregojnë se në Kosovë ekziston legjislacioni adekuat, i njëjti nuk zbatohet si duhet si dhe ekziston një nivel i ulët i llogaridhënies. Mungesa e qasjes në shërbime, ndërhyrjet politike në mundësitë për punësim si dhe nepotizmi i kontribuojnë nivelit të lartë të varfërisë në Kosovë. Prandaj, zhdukja e varfërisë është detyrë e secilit – qoftë si individ, institucion apo si shoqëri.

Me qëllim të vetëdijesimit sa i përket rëndësisë së kësaj teme në kontekstin e Kosovës, Ekipi i Kombeve të Bashkuara në Kosovë (UNKT) dhe Asociacioni i Gazetarëve të Kosovës (AGK) do të organizojnë ndarjen e çmimit vjetor për të 11-ën herë me radhë “Çmimi i Gazetarisë për Varfërinë” që këtë vit do të mbahet më 17 tetor, në ditën ndërkombëtare për zhdukjen e varfërisë, apo në një datë të përafërt për vitin 2016.

Kjo ngjarje kanë për qëllim ngritjen e vetëdijesimit në lidhje arritjen e Objektivit të Zhvillimit të Qëndrueshëm (OzhQ) të parë që është “Jo varfërisë” dhe të kontribuohet në zhvillimin njerëzor.

Për më tepër, të gjithë gazetarët, studentët dhe anëtarët e shoqërisë civile në Kosovë do të inkurajohen të ngarkojnë blogjet në blog ueb-faqen e re të UNKT-së. Temat për këto blogje do të sigurohen duke u bazuar në OZHQ, dhe mund të ndahet (çmimi “Blogu më i mirë”) ashtu siç do të dakordohet mes Agjencive të Kombeve të Bashkuara dhe AKG.

2. Qëllimi

Qëllimi i Çmimit të Gazetarisë për Varfërinë është të promovojë dhe zgjerojë debatin mbi çështjet dhe shkaqet e varfërisë, dhe në mënyrë të tërthorët të ndikohet në uljen e varfërisë përmes presionit ndaj qeverisë për të bërë ndryshime në politika. Në të njëjtën kohë, ky çmim synon të inkurajojë zgjidhje kreative për zvogëlimin e varfërisë përmes priorizimit konstruktiv dhe targetimit efektiv të audiencës.

3. Kriteret e kualifikimit

Storiet do të vlerësohen në bazë të lidhshmërisë së tyre me temën kryesore të varfërisë. Këto ngjarje i inkurajon gazetarët të cilët trajtojnë shkaqet e varfërisë, dhe nëse është e mundur atyre që mbulojnë fuqizimin e gruas në vendimmarrje, ndikimin e mjedisit në shëndet, përfshirë edhe temat e ndërlidhura me përpjekjet institucionale për zvogëlimin e varfërisë përmes masave specifike (të tilla si mbrojtja sociale, punësimi, cilësia e arsimit) dhe marrin parasysh perspektivën e të drejtave të njeriut.

Paneli i vlerësimit do të merr parasysh kriteret e mëposhtme për përzgjedhjen e fituesve:

- Lidhshmërinë e artikullit me temën e varfërisë dhe fokusimin e tij strikt në një nga fushat për zhdukjen e varfërisë.

- Adresimin e çështjes(ve)
- Cilësinë gazetareske – përfshirë objektivitetin, analizat kritike, njohuritë dhe etikën në trajtimin e temës;
- Diversiteti: përpjekjet për të siguruar që diversiteti i etnive, zërave dhe ideve në Kosovë pasqyron jetën në një mënyrë të mirë.
- Thellësia dhe mbulueshmëria e stories: ndikimi që ka pasur stria dhe reagimi pasues, nëse është i mundur;
- Kreativiteti dhe stili

Kriteret shtesë për vlerësim, që nuk janë vendimtare, do të jenë tri temat e komunikimit të OKB në Kosovë për këtë vit:

- Barazia gjinore dhe fuqizimi i grave në vendimmarrje
- Ndikimi mjedisor në shëndet
- Ndërgjegjësimi publik për Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm (përkatesisht “Objektivat Globale”) dhe rëndësia e tyre për Kosovën.

Punimet duhet të jenë publikuar mes 18 shtatorit të vitit 2015 dhe deri më 8 shtator të vitit 2016 (dita kur është publikuar Thirrja për Aplikim).

Të gjitha materialet mund të jenë të shkruara në gjuhën Angleze, Shqipe apo Serbe. Sa i përket gjuhëve të komuniteteve tjera jo-shumicë, punimet duhet të jenë të përkthyer në një nga gjuhët zyrtare të Kosovës apo në gjuhën Angleze.

Konkursi është i hapur për banorët e ligjshëm të Kosovës të moshës mbi 18 vjet. Materialet duhet të jenë publikuar në mediat e Kosovës.

Janë 5 kategori të konkursit të rregullt për gazetarët:

- Video-storia më e mirë (TV, webTV, video etj.)
- Audio-storia më e mirë (Radio, webRadio, etj.)
- Storia më e mirë e shkruar në media të shtypura (Gazeta/revista të botuara në Kosovë dhe në internet vetëm me foto, pa video ose audio)
- Storia më e mirë në internet (me tekst multimedia dhe/ose video dhe/ose audio, etj)
- Fotografia më e mirë (e publikuar në Kosovë dhe që portretizon Kosovën)

Çmimi special 2016

Nëse ka ndonjë publikim të jashtëzakonshëm që nuk hyn në asnjë nga kriteret e mësipërme, UNKT dhe Asociacioni i Gazetarëve të Kosovës, mund të vendosin që të ndajnë një çmim për atë individ. Çmimi special mund të përfshijë artikujt e publikuar më herët në blogjet në internet, media sociale dhe në format e tjera interaktive të shprehjes. Kriteret e përzgjedhjes janë të njëjta me ato të punimeve profesionale

4. Juria dhe procesi i përzgjedhjes



Juria vlerësuese do të përbëhet nga organet e pavarura të krijuara vetëm për këtë qëllim. Dy anëtarë të jurisë do të përzgjidhen nga UNKT dhe do të përfaqësojnë UNKT, ndërsa tre përfaqësues (të paktën dy nga shoqëria civile dhe mundësisht një nga autoritetet) do të përzgjidhen nga AGK. Të paktën një përfaqësues i Asociacionit të Gazetarëve të Kosovës dhe një përfaqësues i Zyrës së Koordinatorit për Zhvillim do shërbejnë si vëzhgues në juri. Procesi i përzgjedhjes do të bëhet nën konfidencialitet rigoroz, masa të transparencës etike dhe barazisë gjinore.

Është e mundur që të shtohet edhe një anëtar i jurisë, nëse konsiderojmë se ka aplikacione të mira sa i përket video-punimeve. Ky anëtar i veçantë i jurisë do të jetë profesionist i filmit/videove, dhe do të vlerësojë cilësinë e kamerës dhe editimit të video-punimeve. Nëse ndodh që të ketë punime shumë të mira, juria mund të vendosë që të ndajë një çmim special për punën më të mirë në video/kamerë/editim. Çmimi do t'i ndahet ekipit përkatës të regjistruar/individit.

Të gjithë anëtarët e përzgjedhur të jurisë kanë njohuri të mirë mbi çështjet e varfërisë në Kosovë, marrëdhënie të mira me mediat dhe kanë aftësi të shkëlqyera të të shkruarit.

- Juria do të përzgjedhë publikimet përfundimtare që më së miri i përmbushin kriteret duke u bazuar në kriteret e mësipërme të pranueshmërisë për secilën prej kategorive të gazetarëve profesionistë dhe jo-profesionistë.
- Fituesit do të shpallen në një ceremoni që do të mbahet në Prishtinë më 17 tetor, 2016.

Punimet duhet të dërgohen tek unkt.ks@one.un.org deri më 7 tetor të vitit 2016 në orën 17:00, me titullin që tregon kategorinë e konkurrimit:

P.sh. "Tema: JPP2016 / Fotografia më e mirë."

Aplikacioni duhet të përmbajë materialet, apo linqet për në materialet, me të gjitha referencat e kërkuara më poshtë:

Emri dhe mbiemri (autori dhe bashkë-autori(ët), nëse aplikohet)	
Adresa, telefoni dhe/apo telefoni mobil	
Adresa elektronike	
Titulli i stories	

Shtëpia Mediatike (nëse aplikohet)	
Data e publikimit/ faqja, Gjatësia (fjalë, apo minuta)	
Vegëza (linku) për: <ul style="list-style-type: none"> • Video (youtube/vimeo) apo ndonjë platformë publike e qasshme në internet, apo e ngarkuar në një online-disk (shared drive) për transferim të fajlave (file transfer drive). Duhet siguruar që punimi të paktën të jetë kompatibil me VLC. • Audio e ngarkuar në një online-disk për shkëmbim të fajlave. Duhet siguruar që punimi të paktën të jetë kompatibil me VLC. • Fotografia/Fotografite – të ngarkuara në një disk për transferim të fajlave me referencën e publikimit. Ju lutemi të siguroni linkun/dhe versionin e skanuar të publikimit • Linkun aktiv, nëse është ende në internet, ndërsa nëse nuk është, atëherë të gjithë përmabajtjen të ngarkuar në një disk për transferim të fajlave • Skanimet e artikujve të mediave të shkruara të ngarkuara në një disk për transferim të fajlave <p>Në rast të vështirësive ju lutemi na kontaktoni.</p>	

5. Çmimet

Çmimet do t'i ndahen autorëve dhe bashkë-autorëve i cili / të cilët ka / kanë dhënë një kontribut shumë të rëndësishëm në zbutjen e varfërisë në aspektin e zhvillimit përmes punës gazetareske dhe publicistike.

Çmimi i gazetarisë

Juria do të përzgjedhë storien më të mirë për secilën kategori. Fituesi i secilës kategori do të shpërblehet me një çmim prej 1,000€ (një mijë euro). Në rast se dy storie të së njëjtës kategori janë shumë të afërta në cilësi atëherë juria rezervon të drejtën që të ndajë çmimin në dy pjesë.

Fituesi i kategorisë së çmimit special (nëse ka ndonjë kandidat të pranueshëm) do të shpërblehet me një çmim prej 1,000 € (një mijë euro). Punimet do të ripublikohen në faqet e internetit të UNKT-së, UNDP-së, AGK-së dhe faqet e tjera të mundshme



Burimet

www.unkt.org

www.undg.org

www.kosovo.undp.org

www.apjk.org

6. Afati kohor dhe adresa

Punimet duhet të dërgohen tek unkt.ks@one.un.org deri më 7 tetor 2016 në orën 17:00, me titullin që tregon kategorinë e konkurrimit:

P.sh. "Tema: JPP2016 / Fotografia më e mirë"

Informata të tjera mund të merren përmes telefonit në 038 249 066, ext. 415/416/418 çdo ditë pune nga ora 08:30 deri në ora 17:30.

SHËNIM: Punimet duhet të përfshijnë emrin e plotë, adresën e banimit, adresën elektronike, numrin e telefonit mobil dhe/ose fiks. Konkurrentët duhet t'a deklarojnë kategorinë e stories, artikullit apo fotografisë së tyre. Për aplikimin, ju lutemi shënoni të dhënat si në formularin e mësipërm. Nëse dy ose më shumë storie/materiale janë të ndërlidhura, ato mund të paraqitet si një punim, dhe pastaj edhe do të vlerësohen si e tillë.